



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 17364 prot.

Shkodër, më 01.07. 2026

VENDIM

Nr. 49, datë 30.06.2026

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR TRAJTIMIN E PASURIVE NR. 805 DHE NR. 806,
ZK 3148, SIPAS LIGJIT NR. 20/2025 "PËR PAKETËN E MALEVE"**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.06.2026, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-komunave/bashkive", i ndryshuar; nenin 8, pika 1, shkronja "a", të Ligjit nr. 20/2025 "Për paketën e maleve"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 714, datë 26.11.2025 "Për shpalljen e disa zonave me përparësi të zhvillimit të ekonomisë malore në Bashkinë Shkodër"; Udhëzimin nr. 2, datë 15.10.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive"; Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mënyrën e paraqitjes së aplikimit dhe procedurën administrative për njohjen si posedues jopronar", si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e pëlqimit për trajtimin, sipas Ligjit nr. 20/2025 "Për paketën e maleve", të pasurive të poshtëshënuara:
Pasuria nr. 805, vol. 4, fq. 189, Zona Kadastrale 3148;
Pasuria nr. 806, vol. 4, fq. 186, Zona Kadastrale 3148.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 38 vota

Vota Pro 26

Vota Kundër 11

Vota Abstenim 1

Zbardhur me datë 01.07.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj

